lajmi.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet më të fundit nga Lajmi.net?
Jo, faleminderit
Pranoj

Prokuroria me aktvendim për ndalimin e disa personave për ngjarjen te “Kino ABC”



05/08/2023 17:04

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka dhënë detaje rreth përleshjes së të premtes që ndodhi lokalin “Bon Vivant” në Prishtinë.

Sipas Prokurorisë, është konstatuar se nga arma e zjarrit kanë rezultuar të plagosur 7 persona, ku njëri nga ta si pasojë nga plagët e marra ka ndërruar jetë në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës.

“Më datën 04.08.2023 në orët e mbrëmjes, prokurori kujdestar i Prokurorisë Themelore në Prishtinë është njoftuar nga ana e Policisë së Kosovës, që në rrugën ‘Rexhep Luci’ në Prishtinë respektivisht në lokalin ‘Bon Vivant’, ka të shtëna me armë zjarri. Me të marrë informacionin, prokurori i shtetit bashkë me njësitet relevante të Policisë së Kosovës, ka konstatuar se si pasojë e të shtënave ka persona të plagosur”, thuhet në komunikatën e Prokurorisë.

Është konstatuar se nga arma e zjarrit kanë rezultuar të plagosur 7 persona, ku njëri nga ta si pasojë nga plagët e marra ka ndërruar jetë në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës. Ndërsa 13 persona të tjerë kanë pësuar lëndime trupore nga gërvishtjet e xhamave apo nga gjësendet tjera. Të gjithë kanë kërkuar ndihmë mjekësore”, thuhet tutje.

Prokurori i rastit në bashkëpunim me Policinë e Kosovë janë duke punuar në drejtim të identifikimit të personave të implikuar në këtë rast me qëllim të zbardhjes së plotë të ngjarjes, është marr aktvendim mbi ndalim ndaj disa personave.

“Prokurori, rastin në fjalë e ka cilësuar ‘Vrasje të rëndë’ neni 173, ‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’ neni 366 dhe ‘Pjesëmarrje në rrahje’ neni 187 i Kodit Penal të Kosovës”, thuhet tutje.

“Ajo që është më rëndësi të ceket se një person gjendet në arrati, ndërsa është konstatuar se gjithë të dyshuarit kanë të kaluar kriminale”, thekson Prokuroria

LAJME TË FUNDIT

Laura Fazliu fiton medaljen e artë në Budapest

Rruga “B” me gjashtë korsi: Fillojnë punimet

Buffon bëhet me punë të re pas pensionimit,...

Shqipëria nga kuverta e një jahti

Artikuj të ngjashëm

August 5, 2023
Rruga “B” me gjashtë korsi: Fillojnë punimet

August 5, 2023
Shqipëria nga kuverta e një jahti

August 5, 2023
Gjermania befasohet nga dimri në pikë të verës

August 5, 2023
Eskalon deputeti Avdylli: Incidentin e mbrëmshëm e lidh me seancën në...

August 5, 2023
Istog: Edhe një i arrestuar për krime luftë ndaj shqiptarëve


August 5, 2023
E rëndë: Nënë e bijë nga Kosova vdesin në aksident komunikacioni...

lajmi.net
info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy